

AFRIM KRASNIQI

**PËRPPJEKJET E PPSH PËR IMPONIMIN E ZGJEDHJEVE
FIKTIVE DHE “PLURALIZMIN E MASAVE” GJATË VITIT 1990**

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 1990 debati mbi zgjedhjet, ligjin zgjedhor dhe konceptin e “pluralizmit të masave”¹ u bënë tema dominuese në ligjërimin zyrtar dhe publik. Arsyet ishin të ndryshme nga përvojat e mëparshme. Debati vinte për shkak të detyrimit ligjor. Kuvendi Popullor i dalë nga votimi fiktiv i 1 shkurtit 1987, kishte zhvilluar punimet në seancë inauguruese më 19 shkurt 1987. Sipas Kushtetutës së RPSSH², Kuvendi përbëhej nga 250 deputetë që zgjidheshin në zona zgjedhjeje me numër të barabartë banorësh. Kuvendi Popullor zgjidhet për një kohë prej katër vjetësh dhe zgjedhjet pasuese duhej të bëheshin “*jo më vonë se tre muaj nga dita e mbarimit të mandatit të tij*”. Zgjedhjet e radhës do të duhej të mbaheshin në shkurt 1991. Në respekt të këtij detyrimi ligjor, më 1 dhjetor 1990, Presidiumi i Kuvendit Popullor dekretoi shpalljen e zgjedhjeve për Kuvendin Popullor të Shqipërisë më 10 shkurt 1991.

Detyrimi më i rëndësishëm ishte ai politik, nevoja për imazh të ri për “procesin e demokratizimit”, i cili konsiderohej prioriteti kryesor i regjimit. Pas ndryshimeve politike në vendet e Evropës Lindore gjatë vitit 1989 presioni nga jashtë dhe brenda për ndryshime edhe në Shqipëri ishte shumë më i madh sesa në çdo vit tjetër të periudhës komuniste. Kriza e thellë sociale dhe ekonomike diktoi ndryshimin e sjelljes politike të vetë regjimit. Ai kishte nevojë për një qasje të re ndaj institucionit të munguar të zgjedhjeve, për më shumë legjitimitet të tyre në raport përpara presionit perëndimor, për rritje të rolit të Kuvendit Popullor, si dhe për lidhje më të fortë midis zgjedhësve dhe të zgjedhurve. Presioni nga jashtë

¹ Termi “pluralizëm i masave” nuk ekziston në fjalorin politik të Oxford-it dhe as në konceptet e shkencave politike. Është term i përdorur në Shqipërinë e fundvitit '90, sipas të cilit, organizatat e masave, satelite me PPSH-në, mund të shpallehin si subjekte elektorale formale konkurruese duke u paraqitur si pluralizëm brenda sistemit dhe duke zëvendësuar në këtë mënyrë pluralizmin politik.

² *Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste*, neni 68, Tiranë, 1976.

në nivelin politik për pluralizëm politik e sistem konkurrues, presioni nga brenda për më shumë demokraci e hapje si dhe nevoja e vetë PPSH për një qasje të re në përpjekjet për ruajtjen e pushtetit në kushtet e reja politike, i bënë zgjedhjet e radhës për Kuvendin Popullor një test dhe sprovë të rëndësishme.

Debati mbi zgjedhjet ishte risi në Shqipërinë komuniste. Gjatë sistemit njëpartiak koncepti dhe institucioni i zgjedhjeve ishin formal dhe zgjedhjet e fundit me ndikim në debatin publik datonin në vjeshtën e vitit 1945. Në secilin prej proceseve të tjera zgjedhore procedura kishte qenë fiktive, Kuvendi ishte formal në ushtrimin e aktivitetit të tij, numri i deputetëve kishte më shumë vlerë statistikore sesa cilësore dhe e drejta e kandidimit ishte monopol i PPSH.

Debati mbi zgjedhjet do të duhej të trajtonte çështje thelbësore të sistemit politik, përfshirë raportet midis PPSH dhe sistemit politik, raportin e PPSH me Kushtetutën, rolin e grupimeve të mundshme, rolin e individëve që aspirojnë politikën, si dhe rolin e institucioneve për të ndarë dhe mbajtur përgjegjësi. Në dhjetor 1990, pak ditë përpara dekretimit të pluralizmit politik, secila prej këtyre sfidave rezultonte e papërbushur. Regjimi nuk kishte arritur të krijonte një eksperiment zgjedhor funksional e të besueshëm, por as të shuante kërkesat e presionet e brendshme e të jashtme për procese reale demokratike.

Presioni i Perëndimit dhe reagimi i Tiranës

Në përshëndetjen e vitit të ri 1990, Kryetari i Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe Sekretari i Parë i PPSH-së, Ramiz Alia, paralajmëroi qëndrim të ashpër ndaj cilido që kërkon e pret ndryshime politike në Shqipëri. Sipas tij, “askujt nuk i kemi lejuar dhe kurrë nuk do t’i lejojmë të na diktojë ligjet dhe normat e tij”³. Plenumi i janarit 1990 doli me tezën se pluralizmi politik do të çonte në dobësimin e unitetit kombëtar, në humbjen e pavarësisë dhe në shkatërrimin e socializmit⁴. Lidhja midis unitetit, pavarësisë dhe socializmi përdorej si alibi në ligjërimin politik brenda e jashtë vendit. Për vetë regjimin, mungesa e shumë partive nuk do të thoshte “mungesë e demokracisë”⁵ dhe në funksion të kësaj teze të

³ Ramiz Alia, “Vija e Partisë - vija e lirisë, e sovranitetit të plotë kombëtar e popullor”, Përshëndetje e vitit të ri 1990, në gazetën *Bashkimi*, Tiranë, më 1 janar 1991.

⁴ “Mbi thellimin e masave për revolucionarizimin e jetës së partisë dhe të gjithë vendit”. Vendim i Plenumit të 9-të të KQ të PPSH, në gazetën *Bashkimi*, Tiranë, më 4 shkurt 1990.

⁵ Po aty.

re, PPSH sugjeroi zëvendësimin e konceptit pluralist politik me konceptin e “pluralizmit të masave”, përmes demokratizimit të brendshëm dhe pjesëmarrjes së masave e organizatave të tyre në konsultime të ndryshme.

Plenumi rekomandoi zhvillimin e mbledhjeve të hapura të organizatave bazë të PPSH, ftesën që qytetarët të mund të marrin pjesë në këto debate brenda partisë, aplikimin e një sistemi më konkurrues për zgjedhjen nga kolektivat e drejtuesve të njësisve të prodhimit, kufizimi i disa prej mandateve të shumta që mbajnë zyrtarët e lartë në nivele të ndryshme etj. Për Shqipërinë e janarit 1990 masa të tilla liberalizuese ishin pozitive, por të pamjaftueshme. Për shtetet dhe organizatat perëndimore ndryshimet ishin kozmetike, devijime nga konteskti dhe natyrisht edhe të pamjaftueshme.

Gjatë Plenumëve IX, X, XI dhe XII të vitit 1990, regjimi komunist shpalli prioritet të rëndësishëm ndryshimin e kursit në politikën e jashtme, gatishmërinë për rivendosjen e marrëdhënieve me të gjitha shtetet perëndimore, përfshirë SHBA, si dhe synimin për aderim në organizata ndërkombëtare, përfshirë KSBE (sot OSBE). Në qershor 1990, Shqipëria u pranua me statusin e vëzhguesit në KSBE në samitin ku kjo organizatë hodhi bazat e një sistemi demokratik evropian. Samiti i Kopenhagenit sanksionoi parimin e respektit të së drejtës së individëve ose grupeve të individëve për të krijuar, në liri të plotë, partitë e tyre politike, ose organizata të tjera politike si dhe detyrimin e shteteve që t’u ofrojnë këtyre partive dhe organizatave politike të gjitha garancitë e nevojshme ligjore për t’u dhënë mundësi që të konkurrojnë me njëra-tjetrën në mënyrë të barabartë përpara ligjit dhe autoriteteve.

Pas Samitit të Kopenhagenit detyrimi për standarde demokratike, pluralizëm dhe zgjedhje të lira e konkurruese, u bënë mesazh unik i të gjitha vendeve të KSBE adresuar Shqipërisë. Sekretari amerikan Bejker kushtëzoi rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me pranimin e pluralizmit politik dhe ecjen e vendit drejt ekonomisë së tregut⁶. Gjithashtu, dy delegacione të Kongresit Amerikan që vizituan Tiranën në maj 1990 shprehën të njëjtin vlerësim⁷. Një deklaratë e Sekretarit të Shtetit Amerikan në Paris se SHBA mbështetin zhvillimin e pluralizmit politik në vendet e Evropës Lindore, si dhe përpjekjet e tyre aktuale drejt

⁶ Elez Biberaj, *Shqipëria në Tranzicion: rruga e vështirë drejt demokracisë*, AIIS, Tiranë: 2011, f. 80.

⁷ Po aty, f. 80.

vendosjes së një ekonomie tregu⁸, për herë të parë nuk u censurua në mediat kryesore të regjimit, Agjensia Telegrafike Shqiptare (ATSH), gazeta “Zëri i Popullit” (ZP) dhe gazeta “Bashkimi” (GB).

Presioni nga jashtë për lejimin e pluralizmit politik u konfirmua në disa deklarime dhe dokumente publike të vetë kreut të shtetit komunist, Ramiz Alia. Në fjalimin e tij me intelektualët më 10 gusht 1990, të përmbledhur në botimin e brendshëm “*Demokratizimi në rrugën e Partisë*”, Alia foli për sulm të egër të Perëndimit kundër socializmit dhe komunistëve⁹ në vendet e ish Bllokut Lindor. Referuar organizatave ndërkombëtare, kryesisht KSBE dhe BB, Alia tha se nga pranimi ose jo i kushteve të tilla varet pjesëmarrja në këto organizma¹⁰.

Tradita e “pluralizmit të masave” dhe përvoja lindore

Shqipëria gjatë periudhës 1945-1990 pati vetëm një subjekt elektoral. Në proceset zgjedhore 1945-1987 i vetmi subjekt zyrtar në zgjedhje ishte Fronti Demokratik (FD), organizatë satelite ku PPSH kishte rol udhëheqës. Kreu i regjimit komunist, Enver Hoxha ishte njëherësh edhe kryetar i Frontit Demokratik, post që pas vdekjes së tij, deri në dhjetor 1990, e ushtroi bashkëshortja e tij, Nexhmije Hoxha. Kjo praktikë u ndoq pavarësisht se me ligjin për zgjedhjet në Kuvendin Popullor të vitit 1950 (ndryshuar më 1952 dhe 1958)¹¹, neni 45 përcaktonte se, të drejtë propozimi për kandidatë kanë PPSH, Fronti Demokratik, Bashkimet Profesionale (BP), Bashkimi i Grave (BG), si dhe organizatat kooperativiste dhe shoqatat kulturore. E drejta ishte fiktive dhe vetë ligji impononte mbledhje të strukturës drejtuese të këtyre organizatave, të cilat, ligjërisht ishin organe varësie dhe përbërëse të PPSH. Edhe me ligjin organik¹² mbi zgjedhjet 1966, i cili mbeti në fuqi deri në nëntor 1990, në nenin 18 përcaktohej se kanë të drejtë të paraqesin kandidatë në zgjedhjet e Kuvendit Popullor organizatat e masave: Organizatat e Partisë së Punës të Shqipërisë, të Frontit

⁸ “Kronikë e turit evropian të sekretarit Bejker”, në gazetën *Bashkimi* dhe *ATSH*, Tiranë, më 5 shkurt 1990.

⁹ Ramiz Alia, *Demokratizimi në rrugën e Partisë*, Botim i KQ të PPSH, Tiranë: 1990, f. 9.

¹⁰ *Po aty*, f. 9-10.

¹¹ Ligji nr. 2624, datë 17.3.1958, “Mbi zgjedhjet e Kuvendit Popullor”, në *Fletore zyrtare*, 4, 1958.

¹² Ligji nr. 4121, datë 17.3.1966, “Mbi zgjedhjet e Kuvendit Popullor”, në *Fletore Zyrtare*, 4, 1966.

Demokratik, të Bashkimeve Profesionale, të Rinisë, të Gruas dhe organizatat e tjera të masave.

Praktika e krijimit të subjekteve konkurruese fiktive ishte aplikuar në periudha të ndryshme edhe në vendet e tjera ish komuniste, por në asnjë vend tjetër nuk u aplikua në zgjedhjet e viteve 1988-1990 që sollën ndryshimin e sistemit. Referuar të dhënave, modeli i pluralizmit të masave, subjekteve fiktive ose subjekteve konkurruese brenda Frontit komunist ishte aplikuar gjerësisht në Poloni e Çekosllovakia dhe, për një periudhë të shkurtër kohe, edhe në vende të tjera si Bullgaria, Rumania etj. Konkretisht, gjatë periudhës komuniste në Poloni subjekti zyrtar konkurrues ishte Fronti i Bashkimit Kombëtar¹³, por brenda tij zyrtarisht figuronin si konkurrues Partia e Bashkuar Punëtore, Partia e Bashkuar Popullore, Partia Demokratike dhe kandidatët e pavarur. Polonia e ruajti këtë traditë edhe në zgjedhjet e fundit komuniste më 1985, në të cilat zyrtarisht katër subjektet e mësipërme brenda Frontit fituan respektivisht 245, 106, 35 dhe 74 mandate. Edhe në Çekosllovakia sistemi me parti konkurruese direkt ose indirekt (brenda Frontit) u ruajt deri në mesin e viteve '60¹⁴. Në disa vende të tjera “pluralizmi i limituar” u aplikua vetëm në zgjedhjet e para që sanksionuan vendosje e regjimeve totalitare (Hungaria në zgjedhjet e vitit 1949 pati 6 subjekte¹⁵, Rumania në zgjedhjet e vitit 1948 pati 3 subjekte¹⁶, Bullgaria më 1946 pati gjithashtu, 7 subjekte zgjedhore¹⁷.

Në vitet 1989-1990 kur u zhvilluan zgjedhjet e para drejt sistemit të ri politik, në asnjë vend tjetër të Evropës Lindore, përfshirë Poloni, Bullgari, Rumani, Çekosllovakia, Hungari, etj., nuk pati subjekte fiktive elektorale, por parti politike reale dhe kandidatë realisht të pavarur. Asnjëri vend nuk aplikoi modelin shqiptar të “pluralizmit të masave”, por në forma të ndryshme, konsensuale apo të imponuara, praktikuan pluralizmin konkurrues politik. Në kontrast me këtë përvojë, në mesin e vitit 1990, Shqipëria vijonte të ishte përjashtim nga ecuria e procesit historik dhe demokratik në Evropën Lindore. Oferta e pluralizmit përmes subjekteve fiktive të organizatave të masave ishte në nivelin e vitit 1958

¹³ Dieter Nohlen & Philip Stöver, *Elections in Europe: A data handbook*, Germany: Nomos, 2010, f. 1491.

¹⁴ *Po aty*, f. 457.

¹⁵ *Po aty*, f. 899.

¹⁶ *Po aty*, f. 1598.

¹⁷ *Po aty*, f. 368.

apo 1966, dhe dekada larg përvojës së vetë vendeve të tjera ish komuniste. Vendimi i nëntorit 1990 për të krijuar “pluralizmin e masave” si ofertë në vend të pluralizmit politik, duke njohur si subjekte elektorale, krahas PPSH, edhe FD, BP, BG, BR dhe KV, kishte vetëm ndonjë dallim teknik nga ligji i vitit 1952, 1958 dhe 1966. Ai njihte edhe konceptin e kandidimit të pavarur me mbështetjen e 300 firmave, si dhe hiqte kufizimet e mbledhjeve të dokumentuara të strukturave drejtuese të organizatave të masave, duke ia kaluar përgjegjësinë mbledhjeve të hapura popullore.

Koncepti minimalist i zgjedhjes dhe pluralizmi fiktiv

Burimet e referimit për debatin mbi zgjedhjet dhe “pluralizmin e masave” janë të kufizuara dhe kryesisht vetëm në aktet e organeve të larta të regjimit. Nga shfletimi i dokumentacionit arkivor mbi mbledhjet e Byrosë Politike, të Sekretariatit të Komitetit Qendror, të Presidiumit të Kuvendit Popullor, të Mbledhjeve të Këshillit të Ministrave etj., rezultojnë se niveli i informacionit dhe sidomos i ndërgjegjësimit të elitës politike drejtuese të vitit 1990 mbi konceptet e zgjedhjeve, të pluralizmit dhe të konkurrencës së lirë ishin minimale dhe të deformuara. Disa prej tyre, përfshirë kreun e regjimit Alia, të njohur nga afër me zhvillimet e njëjta në vendet e tjera ish komuniste ishin të ndërgjegjshëm mbi pasojat e mundshme të pluralizmit politik për vetë ata dhe sistemin, kurse shumica mbetej spektatore dhe peng i sloganeve shabllone në këtë drejtim. Alibia refuzuese e përdorur nga Alia dhe të gjithë përfaqësuesit e regjimit ishte e njëjtë: “Shqipëria është rast i veçantë”, “as Lindje dhe as Perëndim”; “pluralizmi krijon përçarje dhe dëmton unitetin, pavarësinë e sovranitetin”, “pluralizmi rikthen në pushtet forcat reaksionare dhe tradhtarë të Luftës Dytë Botërore”. Në funksion të kësaj teze për ecjen graduale dhe specifike, në takimin me Sekretarin e Përgjithshëm të OKB, de Kuelar më 12 maj 1990, Alia tha se “do të na duhet një fazë përgatitore dhe transitore për t’u njohur me dokumentet dhe aktet e shumta të organizmave ndërkombëtarë dhe për t’u përgatitur me to”¹⁸.

Tri prej mbledhjeve dhe materialeve të rëndësishme referuese mbi konceptet minimale për zgjedhjet dhe konceptet e deformuara të pluralizmit janë mbledhjet e Byrosë Politike më 6 nëntor 1990, të

¹⁸ Njoftimi zyrtar i pritjes së Sekretarit të Përgjithshëm Javier Peres de Kuelar, në gazetën *Bashkimi*, Tiranë, më 13 maj 1990, f. 2.

Plenumit të 12 të KQ më 6 dhe 7 nëntor 1990, si dhe në mbledhjen e Kuvendit Popullor më 12 nëntor 1990. Janë mbledhje të zhvilluara vetëm një muaj nga data kur PPSH u detyrua të pranojë dhe të ligjërojë pluralizmin politik në Shqipëri, pra në ditët dhe javët e fundit të regjimit. Plenumi në vend të pluralizmit politik njohu pluralizmin e masave, një eksperiment e devijim nga standardet demokratike të zgjedhjeve dhe të konkurrencës. Përmes kësaj oferte synohej të sigurohej një përfaqësim pluralist i masave në pushtet¹⁹.

Koncepti i regjimit komunist për pluralizmin politik bazohej vetëm në zgjerimin e bazës konsultative të vetë PPSH dhe organizatave të saj të masave, pa cenuar sistemin dhe rolin e saj udhëheqës. Sipas Byrosë, pluralizmi politik ishte jetësuar nëpërmjet tërë subjekteve të shumta që ekzistonin në sistemin politik, nëpërmjet Partisë së Punës, por edhe të organizatave të masave e shoqatave të ndryshme, nëpërmjet organizatave ekonomike etj., siç ishin kooperativat bujqësore, por edhe të Kuvendeve të mëdha e odave të vogla, diskutimit fshatçe të problemeve politike, ekonomike, shoqërore etj. Praktikën e propozimeve dhe konsultimeve brenda organizatave të masave, pra të zgjerimit të bazës së organizatave²⁰, PPSH e konsideronte zgjedhje nga populli dhe tregues superioriteti i rendit socialist²¹. Me ndryshimet e reja, subjektet dhe kandidatët konkurrues kishin të drejtë të shprehnin diversitet mendimesh për çështje e problematika që nuk cenonin parimet socialiste dhe rendin politik në fuqi.

Analiza e mbledhjeve të tjera të rëndësishme, përfshirë mbledhjen e Byrosë Politike dhe të Plenumit të 13 të KQ, më 11 dhjetor 1990, nxjerr në pah mungesën e koncepteve të qarta mbi pluralizmin dhe zgjedhjet edhe në rrethanat e debatit të imponuar për lejimin e pluralizmit, por mbi të gjitha, mungesa e plotë e vullnetit për ta pranuar pluralizmin politik. Figura të njohura të Byrosë dhe KQ, ndonëse pranonin lejimin e organizatës politike të studentëve të imponuar nga Lëvizja Studentore e 8-10 dhjetorit, ishin kategorik kundër lejimit të partive të reja politike.

¹⁹ Arkivi Qendror Shtetëror i Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi 14/Arkivi Qendror (AQ) i PPSH, dosja (më tej: D.) 28, fl. 27. Procesverbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ, 6.11.1990.

²⁰ Po aty, F. 14/AQ i PPSH, V. 1990, D. 4, fl. 25. Diskutim në Byronë Politike. "Forcimi i pushtetit popullor dhe përvoja e tërë sistemit politik fuqizon zhvillimet demokratike", 6.11.1990.

²¹ Po aty, fl. 31. Diskutim në Byronë Politike. "Forcimi i pushtetit popullor dhe përvoja e tërë sistemit politik fuqizon zhvillimet demokratike", 6.11.1990.

Pyetja se si mund e duhej të sillej PPSH në rrethanat e një pluralizmi të mundshëm politik nuk mori përgjigje nga Byroja dhe as nga Plenumi.

Rol në debat dhe në konceptet minimaliste pati edhe media zyrtare. Në metodikën e punës së PPSH, pas çdo akti me rëndësi politike, mediat zyrtare orientoheshin të publikonin informacione, argumente, intervista dhe komente mbështetëse. Qëllimi ishte i dyfishtë: nxitja e debatit publik brenda kuadrit politik e ligjor të kohës, si dhe nxitja e emrave të njohur të jetës publike për të dhënë mendime e gjykime mbështetëse për regjimin. E njëjta praktikë u ndoq edhe gjatë vitit 1990 me ngjarjet kryesore, vendimet e pranverës për disa ndryshime kushtetuese e ligjore, mekanizmin e ri ekonomik, ngjarjet e ambasadave etj. E njëjta praktikë u ndoq edhe për ligjin e zgjedhjeve dhe debatin mbi pluralizmin.

Një ditë përpara mbledhjes dhe votimit zyrtar në Kuvendin Popullor, më 11 nëntor gazeta “Zëri i Popullit” botoi një material special²² “13 pyetje për projektligjin për zgjedhjen e deputetëve” me opinione të drejtuesve juridikë në Kuvend dhe në Presidiumin e Kuvendit, Frrok Gjoka, Kujtim Puto dhe Leon Kosta. Drejtuesit juridikë dhanë sqarime në detaje për parimet dhe specifikat e ligjit, sidomos në pikat që lidhen me cilësinë e subjekteve konkurruese, numrin e nënshkrimeve, fushatën në publik, programin elektoral, mandatin dhe vendbanimin etj. Secili nga shpjegimet ishte brenda kuadrit të ligjërit ideologjik e zyrtar të kohës. Gjatë muajve korrik – nëntor pati edhe raste të tjera kur mediat kryesore politike të regjimit publikuan komente dhe editoriale lidhur me zgjedhjet dhe ofertën e pluralizmit të mendimit të ofruar nga PPSH. Drejtori i ligjshmërisë në Presidium Kujtim Puto në komentën e tij²³ e cilësoi ligjin si “nivele i lartë i emancipimit të shtetit dhe të shoqërisë” dhe vlerësoi me nota të larta traditën e PPSH në zgjedhje, sipas të cilës nuk kishte akuza për falsifikime votash dhe shkelje të ligjit. Juristi Krenar Loloçi në opinionin e tij²⁴ cilësoi risi kandidimin e më shumë se një emri në një zonë zgjedhore. Shkrime të tilla pati edhe nga emra të tjerë të njohur, kryesisht individë pranë kabinetit të Presidiumit apo intelektualë që ishin edhe deputetë në Kuvendin Popullor. Secili koment dhe opinion ishte

²² “13 pyetje për projektligjin për zgjedhjen e deputetëve”, në gazetën *Zëri i Popullit*, 11.11.1990, f. 3.

²³ Kujtim Puto, “Hap i rëndësishëm për demokratizimin e mëtejshëm të jetës së vendit”, në *Zëri i Popullit*, Tiranë, më 1.1.1990, fl. 2-3.

²⁴ Krenar Loloçi, “Demokratizim i mëtejshëm i mekanizmit të zgjedhjeve”, në gazetën *Zëri i Popullit*, Tiranë, më 1.7.1990, f. 1.

brenda linjës zyrtare dhe në mbështetje të “pluralizmit të masave” të propozuar nga PPSH.

A kishte opinion të ndryshëm në Shqipërinë e vjeshtës së vitit 1990? Ekzistenca e pakënaqësive për ligjin e ri zgjedhor dhe ofertën e pluralizmit të masave në vend të pluralizmit politik konkurrues, konfirmohet nga të paktën dy zyrtarë të lartë, Sekretari i KQ mbi Ideologjinë Foto Çami dhe ministri i Brendshëm, Hekuran Isai. Në Plenumin XII të KQ Çami, pranoi se në disa qarqe intelektuale, por edhe studentore, ekzistonte mendimi se ajo çka kemi bërë është minimale, se ndryshimet e deritanishme janë kozmetike, se procesi i demokratizimit pothuajse ka ngecur, prandaj në radhët e tyre flitet edhe për një lloj zhgënjimi²⁵. Kurse, ministri i Punëve të Brendshme Hekuran Isai në të njëjtën mbledhje tha se në bulevard njerëzit flasin haptazi për pluralizmin politik dhe kërkesën për shumë parti²⁶.

Ligji për zgjedhjet, debatet në Byro, Plenum dhe Kuvendin Popullor

Në muajin shkurt 1990, Byroja Politike pati caktuar disa ekspertë dhe zyrtarë të lartë për rishikimin e ligjit të zgjedhjeve të vitit 1966 dhe përshatjes së tij me situatën e re politike në vend. Prosesi i rishikimit të ligjit zgjati disa muaj, derisa më 24 tetor projektligji u botua i plotë në gazetën kryesore politike, “Zëri i Popullit” dhe “Bashkimi”. Brenda rreth dyjavësh Presidiumi i Kuvendit Popullor organizoi mbledhje të komisioneve parlamentare në Kuvend për të debatuar mbi ligjin dhe disa akte të tjera ligjore në rend të ditës. Praktika e mbledhjes së komisioneve parlamentare të Kuvendit kishte qenë formale për dekada me rradhë, por më 1990, PPSH e avancoi ndryshimin e traditës, duke publikuar në mediat zyrtare përmbledhje nga vetë debatet në komisione.

Sipas praktikës së punës në sistemin njëpartiak në Shqipëri çdo vendim i rëndësishëm politik diskutohej fillimisht në Byronë Politike dhe Sekretariatit e Komitetit Qendror, më pas në Plenumin e KQ dhe vetëm më pas në strukturat e tjera partiake dhe shtetërore, përfshirë qeverinë dhe Kuvendin Popullor. E njëjta linjë pune u ndoq edhe në debatin për ligjin e ri të zgjedhjeve të vitit 1990. Fillimisht ishte Byroja Politike, e cila dha

²⁵ AQSH, F. 14/AQ i PPSH, V. 1990, D. 4, fl. 84. Procesverbal i mbledhjes së Plenumit 12 të KQ.

²⁶ Po aty, fl. 92. Procesverbal i mbledhjes së Plenumit 12 të KQ.

orientimet bazë dhe më pas Plenumi XII, i zhvilluar më 6-7 nëntor 1990, diskutoi gjerësisht mbi skemën e re zgjedhore me subjekte organizatat e masave. Një javë pas tyre u zhvilluan punimet e Kuvendit Popullor ku ligji mori formë zyrtare.

Në mbledhjen e Plenumit XII të KQ, me cilësinë e anëtarëve ose kandidatëve të KQ, ishin të ftuar të gjithë drejtuesit kryesorë të organizatave të masave, të cilat me ligj do të duhej të ishin subjekte të reja dhe të pavarura elektorale krahas me PPSH. Thelbi i diskutimeve të anëtarëve të Byrosë dhe të Plenumit ishte pikërisht raporti i ri që do të duhej të ndërtohej midis PPSH dhe organizatave të masave. Kryetari i Bashkimeve Profesionale, Sotir Koçollari ishte i pari kryetar i një subjekti “të pavarur” që duhej të fliste. Ai mbështeti idenë për t’i deklaruar organizatat shoqërore subjekte të pavarura dhe e shikoi këtë si një mundësi për të mbështetur më fuqishëm Partinë në zgjidhjen e problemeve të kohës²⁷. Ministret Vito Kapo e Tefta Cami e pyetën atë nëse programi i BPSH do jetë i ndryshëm nga ai i PPSH²⁸. Përgjigjja e Koçollarit ishte e kundërt me atë që përcaktonte ligji dhe që thuhej në publik: “*bazë për hartimin e këtij programi do kemi programin e Komitetit Qendror për Partinë*”. Të njëjtat teza përsëritën edhe drejtuesit e organizatave të tjera satelite.

Një krahasim midis informacioneve që u dhanë në publik dhe atyre që gjenden në procesverbalet origjinale të mbledhjeve të Byrosë, të Presidiumit, të Plenumit, të Sekretariatit dhe të Komisioneve parlamentare në Kuvend, tregon se regjimi përcolli në publik vetëm ato pyetje, teza dhe çështje që nuk përbënin shqetësim dhe as krijonin keqkuptim nga qytetarët. Për shembull, debati mbi të drejtën e krijimit të partive të reja politike nuk bën pjesë në asnjë nga kronikat e mbledhjeve përcjellë në medie, megjithatë gjendet në diskutimet në nivelet e larta të regjimit. Gjithashtu, çështje që kanë të bëjnë me natyrën programore të organizatave të masave, të drejtat e votës në emigracion, kufizimet politike të procesit, rolit të qeverisë në zgjedhje, qëndrimet ndaj fesë etj., të cilat indirekt lidheshin edhe me elementë të rëndësishëm të ligjit zgjedhor, nuk gjenden në informacionet e botuara në mediet zyrtare.

Referuar të dhënave në procesverbale, del se pati përpjekje për të krijuar idenë e konsultimeve të gjera, duke ftuar në mbledhje individë të

²⁷ *Po aty*, fl. 34. Procesverbal i mbledhjes së Plenumit 12 të KQ, 6-7 nëntor 1990.

²⁸ *Po aty*, fl. 36-37. Procesverbal i mbledhjes së Plenumit 12 të KQ, 6-7 nëntor 1990.

tjerë dhe duke i nxitur deputetët që të flisnin në zhvillimin e punimeve të Kuvendit më 13 nëntor për klimën pozitive të ligjit dhe mbështetjen e madhe publike të tij. Në mbledhjen e datës 3 nëntor në Komisionin e Planit dhe të Buxhetit në Kuvend, sekretari i Kuvendit Popullor Xhafer Spahiu²⁹ u kërkoi organizatave shoqërore të kishin programe më vete, duke i orientuar nga lart që në programin e punës të viheshin detyra për kushtet e punës, për probleme të mekanizmit të ri, për novacione etj. Pra, që diferencat programore do të ishin vetëm teknike dhe brenda kuadrit të përgjithshëm të programit të PPSH.

Në mbledhje një numër deputetësh³⁰ bënë pyetje e diskutime, të cilat, në thelb, paraqisnin pasigurinë e frikën ndaj pasojave që mund të kishte ky ligj për rolin e PPSH dhe pushtetin e saj. Deputetët Filip Meshi, Vangjel Daiu, Stefan Papajorgji, Ali Kalaja, Naum Prifti, Gjela Biba, Duro Kapo etj., pyetën kryesisht mbi kufizimet për shoqatat në konkurrim, kufizimin me 2-3 mandate në kandidim, kufirin moshor të kandidimit, të drejtën e votës për përdoruesit e alkoolit, raportet gjinore, mënyrën e bërjes së fushatës etj.³¹ Në sqarimet për ligjin, përfaqësuesi i Kuvendit Popullor, F.Gjoka sqaroi se me emërtim “shoqata” quheshin vetëm organizatat e masave, shoqata e veteranëve dhe e shkrimtarëve, se do lejoheshin vetëm programe në përputhje me ideologjinë dhe vijën “tonë” dhe se programi do miratohej paraprakisht nga zgjedhësit.

Më tej, Komisioni i Planit dhe Buxhetit në Kuvend³² kërkoi saktësimin e të drejtës së votës për shtetasit 18 vjeç, ndalimin e organizatave me program nacionalist, ndalimin e konkurimit për individët e dënuar³³ etj. Nga Komisionet e tjera sugjerimet kishin të bënin³⁴ me të drejtën e kandidimit të shoqatave shkencore, detyrimin që kandidimi të miratohej nga kolektivi i zgjedhësve në zonë, votimi në përfaqësitë diplomatike dhe përdorimi i gjuhës së pakicave në zonat e tyre.

Në seancën e Kuvendit Popullor më 12 nëntor 1990 u diskutua dhe u miratua ligji mbi “Zgjedhjet për Kuvendin Popullor”. Në përpyekje për t’i

²⁹ *Po aty*, Fondi i Presidiumit të Kuvendit Popullor. Procesverbal i mbledhjeve , V. 1990, D. 4, fl. 21, Tiranë, 3.11.1990.

³⁰ *Po aty*, Fondi i Presidiumit të Kuvendit Popullor. Procesverbal i mbledhjeve , V. 1990, D. 53, fl. 1, Tiranë, 3.11.1990.

³¹ *Po aty*, fl. 20, Tiranë, 3.11.1990.

³² *Po aty*, fl. 1, Tiranë, 3.11.1990.

³³ *Po aty*, fl. 2, Tiranë, 3.11.1990.

³⁴ *Po aty*, fl. 3, Tiranë, 3.11.1990.

dhënë legjitimitet procesit dhe për të krijuar idenë e një produkti legjitim ndërinstitucional të konsultuar gjerësisht, në punimet e Kuvendit u paraqitën disa relacione mbi projektligjin. Në seancë u raportua se projektligji ka kaluar në debate në tetë komisionet parlamentare midis periudhës 26 tetor dhe 5 nëntor, dhe se secili komision i ka përcjell mendime e sugjerime të ndryshme³⁵.

Relacioni kryesor ishte ai i Presidiumit të Kuvendit Popullor, paraqitur nga deputetja Eleni Selenica, njëherësh drejtuese në Gjykatën e Lartë. Relacioni u botua edhe në gazetën “Zëri i Popullit” datë 13 nëntor 1990. Në relacion specifikohet se *jo çdo shoqatë do të jetë subjekt politik për të paraqitur kandidatë për deputetë*, duke përjashtuar ato të natyrës profesionale dhe duke cituar si subjekte legjitime vetëm “PPSH, FDSH, BP, BR, BG, Komiteti i Veteranëve (KV), si dhe çdo organizatë ose shoqatë tjetër politiko-shoqërore e njohur me ligj. Në fakt, në takimin e R. Alisë me përfaqësues të organizatave të masave në shtator 1990, ai foli³⁶ për ndryshimet në ligjin e zgjedhjeve dhe përmendi edhe Akademinë e Shkencave dhe Bashkimin e Gazetarëve si subjekte të reja elektorale, krahas organizatave të masave. Në Plenumin XII të KQ, Alia e zgjeroi listën e subjekteve, duke përmendur edhe shoqatën ekologjike dhe të gjeologëve³⁷, kurse në variantin zyrtar të ligjit të miratuar një javë më pas, nuk bënin pjesë as Akademia, as Bashkimi i Gazetarëve, as shoqata ekologjike dhe as shoqata e gjeologëve. Arsyet lidhen me mungesën e nevojës për të pasur më shumë subjekte fiktive, me paqartësitë e vetë regjimit mbi jetësimin konkret të lojës me subjektet fiktive, si dhe me faktin se prioritet morën vetëm organizatat e njohura satelite të PPSH.

Pavarësisht nga ndryshimi dhe paqartësitë mbi numrin dhe llojin e organizatave të masave të ngarkuara si subjekte elektorale në zgjedhje, vetë ky përcaktim paraqet disa problematika: *e para*, në momentin kur ky ligj hyri në fuqi, me përjashtim të subjektit politik kryesor, Partisë së Punës të Shqipërisë, asnjë prej subjekteve të tjera konkurruese nuk ishin “organizata ose shoqata politiko-shoqërore të njohura me ligj”. Duke qenë organizata satelite brenda PPSH, krijimi dhe funksionimi i tyre nuk

³⁵ “Përfunduan mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Kuvendit Popullor”, në *Zëri i Popullit*, Tiranë, më 6.11.1990.

³⁶ “Demokratizimi i sistemit politik – vazhdim i programit të Partisë”, në gazetën *Bashkimi*, Tiranë, më 7.9.1990, f. 2.

³⁷ *AQSH*, F. 14/AQ i PPSH, D. 4, fl. 25. Diskutim në Byronë Politike. “Forcimi i pushtetit popullor dhe përvoja e tërë sistemit politik fuqizon zhvillimet demokratike”, 6.1.1990.

kishte referencë mbështetëse ligjore, por bazohej në aktet e Byrosë Politike dhe të Komitetit Qendror të PPSH në vite. Asnjëra prej tyre nuk jepte llogari mbi bazën e ndonjë ligji përpara gjykatës ose një autoriteti tjetër kushtetues, përveçse përpara strukturave të larta drejtuese të PPSH; *e dyta*, titullarët e organizatave të masave, njëherësh edhe subjekte elektorale, emëroheshin dhe shkarkoheshin nga vetë PPSH dhe strukturat e saj. Sipas Statutit të PPSH secili prej titullarëve duhej të jepte llogari periodike në Byronë Politike dhe strukturat e tjera drejtuese të PPSH; *e treta*, koncepti “*organizatë apo shoqatë politiko-shoqërore*” krijon problematikë në interpretim. Gjatë muajit nëntor 1990 listës së subjekteve iu shtua edhe Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve, një organizatë shoqërore gjithashtu me titullarë të emëruar nga strukturat e larta të PPSH. Por nëse Lidhja e Shkrimtarëve mund të ishte subjekt, atëherë me statut të njëjtë ishin edhe organizata të tjera me natyrë profesionale, të cilat projektligji i përjashtonte nga e drejta e regjistrimit dhe e kandidimit.

Risia për kandidim të lirë nga individë me mbështetje të 300 nënshkrimeve në zonën elektorale apo të kandidatëve nga subjekte të ndryshme elektorale brenda sistemit politik, vinte në kontrast të thellë me procedurën e mëtejshme të ecurisë së kandidimit. Ligji³⁸ ruante konceptin e konsultimit paraprak të kandidaturave me zgjedhësit, një koncept tipik i shteteve njëpartiake dhe me regjime autoritare. Sipas Presidiumit, “përmes kësaj tradite demokratike të sprovuar gjatë 45 vjetëve të organizimit të zgjedhjeve” bëhej në praktikë një verifikim i drejtësisë e i saktësisë së propozimeve dhe, bashkë me to, edhe korrigjimet e ndryshme përkatëse mbi bazën e vërejtjeve të vetë zgjedhësve. Praktika e konsultimit paraprak të kandidatëve me zgjedhësit shkonte aq larg sa u krijonte të drejtë zgjedhësve në takim për propozime të reja si dhe me detyrimin e subjekteve konkurruese për të reflektuar mendimet e zgjedhësve mbi kandidatët.

Relacioni i dytë i rëndësishëm ishte ai i Komisionit Juridik në Kuvendin Popullor. Në këtë relacion paraqitur nga deputetja Dashurie Gjunksi³⁹ u tha se Komisioni ka pranuar disa prej sugjerimeve të ardhura nga organizatat e masave dhe nga komisionet e tjera në Kuvend. Pikat e debatit midis anëtarëve të Komisionit Juridik lidheshin me

³⁸ “Raport i Presidiumit të Kuvendit Popullor”, në gazetën *Zëri i Popullit*, nr. 271, Tiranë, më 13 nëntor 1990, f. 1.

³⁹ Po aty, f. 2.

moshën minimale për zgjedhjen e deputetëve 18, 21, 23 apo 25 vjeç⁴⁰, numri i nënshkrimeve mbështetëse 300 ose 500 etj. Pjesë e debatit ishte edhe orientimi i Plenumit IX të KQ të PPSH për kufizimin e mandatit të deputetit në 2-3 legjislatura. Komisioni vlerësoi që ky kufizim të mos shprehej në nene detyruese ligjore, por të kishte vlerë orientuese për subjektet konkurruese gjatë procesit të caktimit të kandidatëve.

Në diskutimet në Kuvend numri dy i regjimit, Sekretari i KQ, Foto Çami⁴¹ garantoj se ligji nuk ndryshonte sistemin, por zgjeronte pluralizmin elektoral, krahas atij të mendimeve me përfaqësim pluralist të masave. Deputetët Naum Prifti, Enver Halili, Pilo Peristeri, Dritero Agolli e Skënder Gjinushi⁴² theksuan risitë politike të ligjit, duke e cilësuar atë sanksionim ligjor të zhvillimit të mendimit e opinionit pluralist.

Nga pluralizmi fiktiv 1990 tek pluralizmi politik 1991

Më 1 dhjetor 1990, Presidiumi i Kuvendit Popullor nxori disa dekrete e vendime që lidhen me zgjedhjet për Kuvendin Popullor: dekretin për datën e zgjedhjeve⁴³ (10 shkurt 1991), vendimin për përbërjen e KQZ⁴⁴ dhe dekretin për përcaktimin e zonave elektorale⁴⁵. Sipas vendimit për KQZ, organi kryesor zgjedhor do të kishte 13 anëtarë, me kryetar Rexhep Meidani (dekan i Fakultetit të Shkencave të Natyrës). Në të njëjtën ditë doli edhe dekreti për ndarjen e zonave elektorale, ku rrethet me numrin më të madh të deputetëve do të ishin Tirana (29), Durrës, Elbasan, Fier e Shkodër (19) si dhe rrethet me numrin më të vogël të deputetëve do të ishin Kolonja (2), Përmeti e Gramshi me nga 3 deputetë.

Më 8 dhjetor nisën protestat studentore, më 11 dhjetor pati bisedime zyrtare midis përfaqësisë studentore dhe shefit të regjimit komunist Alia.

⁴⁰ Leon Kosta, "Opinion në "13 pyetje për projektligjin për zgjedhjen e deputetëve"", në *Zëri i Popullit*, Tiranë, më 11 nëntor 1990, f. 3.

⁴¹ Foto Çami, "Diskutim në Kuvendin Popullor, sesioni 8, legjislatura 11", në gazetën *Bashkimi*, Tiranë, më 13 nëntor 1990, f. 2.

⁴² Po aty.

⁴³ "Dekret nr. 7433, datë 1.12.1990, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve të KP", në *Fletore Zyrtare*, nr. 12, dhjetor 1990.

⁴⁴ "Vendim nr. 348 i Presidiumit të Kuvendit Popullor, "Mbi përbërjen e KQZ", në *Fletore Zyrtare*, nr. 12, dhjetor 1990.

⁴⁵ "Dekret nr. 7435, datë 1.12.1990, "Për caktimin e zonave të zgjedhjeve të KP", në *Fletore Zyrtare*, nr. 12, dhjetor 1990.

Lëvizja studentore pati rol përcaktues për ecurinë e mëtejshme politike dhe ndryshimin e sistemit. Ajo u bë mjeti kryesor i presionit nga brenda dhe kërcënimi kryesor politik ndaj regjimit. Për këto arsye ajo diktoi ndryshimet ligjore drejt kalimit në sistemin e ri politik. Po atë ditë, më 11 dhjetor pasdite doli vendimi i Plenumit XII të KQ të PPSH, në pikën 5 të të cilit thuhej⁴⁶ “*Plenumi shprehu mendimin se është në dobi të demokratizimit të mëtejshëm të jetës së vendit dhe të pluralizmit krijimi i organizatave politike të pavarura në përputhje me ligjet në fuqi*”. Në vijim të tij, më 17 dhjetor doli dekreti⁴⁷ që ligjëronte fundin e sistemit njëpartiak dhe lejimin e pluralizmit politik, më 19 dhjetor doli urdhri i ministrit të Drejtësisë për legalizimin e Partisë Demokratike⁴⁸, partia e parë opozitare në Shqipëri qysh prej vitit 1944.

Në kushtet e sistemit të ri shumëpartiak, më 14 dhjetor u zhvillua mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kjo mbledhje pati disa detaje domethënëse. E para, mbledhja u zhvillua në selinë e Presidiumit, pra në selinë e Kryetarit të Presidiumit, i cili ishte njëherësh edhe Sekretari i Parë i KQ të PPSH; e dyta, në njoftimin zyrtar, tre ditë pas lejimit të pluralizmit politik dhe kalimit të Shqipërisë në sistemin pluralist, KQZ vijoi praktikën e periudhës parti-shtet duke u shprehur⁴⁹ se “*vendimet shumë të rëndësishme të plenumeve të kohëve të fundit të KQ të Partisë, veçanërisht të Plenumit të 13-të të KQ të Partisë, kanë krijuar kudo një situatë revolucionare për vënien në jetë të masave të marra nga Partia për thellimin e procesit të demokratizimit në të gjitha fushat e jetës*”; e treta, KQZ deklaroi më tej se po zbatonte me përpikëri të plotë të gjitha përgjegjësitë që burojnë nga ligji për zgjedhjet, ligj i cili vjen në kundërshtim me deklarin në pikën e dytë; e katërta, megjithëse në kushtet e pluralizmit politik, KQZ vijonte të ishte organ “i pavarur”, por i emëruar nga PPSH dhe sekretari i saj i parë.

Në situatën e re subjektet fiktive të organizatave të masave u nxitën të bëjnë ndryshime dhe të prezantojnë programe elektorale e kandidatë në zgjedhje. Një pjesë e madhe e kandidatëve të PPSH përfshirë Ramiz

⁴⁶ AQSH, F. 14/AQ i PPSH, V. 1990, D. 5, fl. 4. “Vendime dhe komunikata e Plenumit të 13 të KQ”.

⁴⁷ Dekret nr. 7442, datë 17.12.1990, “Për krijimin e organizatave dhe shoqatave politike”, në *Fletore Zyrtare*, nr. 1, janar 1991.

⁴⁸ Urdhër nr.12, datë 19.12.1990, “Për miratimin e formimit të Partisë Demokratike”, në *ATSH*, Tiranë, më 19.12.1990.

⁴⁹ Komunikatë e mbledhjes së KQZ, 14 dhjetor 1990, publikuar në gazetën *Zëri i Popullit*, Tiranë, më 15.12.1990.

Alinë, kryeministrin Çarçani dhe figura të tjera të rëndësishme në vitet e ardhshme në krye të së majtës, përfshirë Nanon, Gjinushin, Meidanin, ishin më 1991 njëherësh kandidatë të PPSH dhe të Bashkimit të Rinisë. Kryetarja e Bashkimit të Grave, Lumturi Rexha ishte kandidatë e PPSH e mbështetur nga BG, kryetari i Frontit Adil Çarçani ishte kandidat i PPSH etj. Organizatat e masave vijuan të jenë subjekte të mbështetura direkt nga PPSH, dhe shpeshherë më radikale se drejtuesit e PPSH në qëndrimet e tyre politike. Për shembull, në mbledhjen e Byrosë Politike në janar 1991 ku u diskutua mbi kërkesën e opozitës për shtyrjen e zgjedhjeve u raportua se përfaqësuesit e subjekteve elektorale fiktive, FD (Koçollari), BG (Rexha), BR (Bashkurti), FD (Shkurti) dhe KV (Fuga) në janar 1991 ishin kategorikisht kundër shtyrjes së zgjedhjeve dhe shumë të ashpër ndaj opozitës⁵⁰. Të njëjtën linjë shfaqën edhe një pjesë e dukshme konservatore e Byrosë Politike.

Gjatë ditëve të fundit të muajit dhjetor secila nga organizatat e masave shpalli programin e saj elektorale dhe bëri ndryshime në strukturë. Kështu, më 20 dhjetor 1990, Fronti Demokratik bëri ndryshime, sipas të cilave drejtuesja shumëvjeçare e FD, Nexhmije Hoxha dha dorëheqje dhe vendin e saj e zuri Adil Çarçani, njëherësh edhe kryeministër dhe prej më shumë se një dekadë anëtar i Byrosë Politike të PPSH. Në njoftimin zyrtar theksohej⁵¹ se Çarçani ishte “një nga bashkëpunëtorët më të ngushtë të shokut Ramiz Alia” zyrtarisht kryetar i partisë tjetër politike. Në hyrjen e programit politik të Frontit Demokratik si subjekt elektorale për zgjedhjet për Kuvendin Popullor, thuhet⁵² se FDSH është subjekt “i pavarur politik dhe elektorale” që “i përmbahet qëllimit kryesor të shprehur qysh kur i krijua me iniciativën e Partisë Komuniste të udhëhequr nga shoku Enver Hoxha”. Pjesa tjetër e angazhimeve ishte mbështetëse për “procesin e demokratizimit”, “forcimin e pushtetit popullor dhe mbrojtjen e vlerave socialiste të shoqërisë tonë” dhe parime të tjera të njëjta me PPSH.

⁵⁰ AQSH, F. 14/AQ i PPSH, V. 1991, D. 1, fl. 17. Diskutim në Byrosë Politike për shtyrjen e zgjedhjeve.

⁵¹ “Njoftim zyrtar. U mbledh Këshilli i Përgjithshëm i FDSH”, në gazetën *Bashkimi*, Tiranë, më 21 dhjetor 1990.

⁵² “Programi i Frontit Demokratik të Shqipërisë për zgjedhjet në Kuvendin Popullor”, në gazetën *Bashkimi*, Tiranë, më 26.12.1990.

Në hyrjen e programit politik të Bashkimit të Grave, subjekt elektoral nga organizata e masave, thuhej⁵³ se BGSH *mbështet proceset demokratike të ndërmarra me iniciativën e PPSH dhe do të punojë që ato të jenë të vazhdueshme dhe të pakthyeshme*. Edhe në hyrje të programit elektoral të subjektit “*Organizata e Veteranëve të Luftës*”, ndonëse theksohej se ajo është një subjekt politik i pavarur⁵⁴, citohej me vlerësime maksimale Partia e Punës së Shqipërisë, Enver Hoxha, Ramiz Alia dhe Plenumi XIII i KQ të PPSH, si dhe angazhoheshin për mbrojtjen e trashëgimisë së tyre historike.

Më 22 dhjetor zhvilloi mbledhjen e vet edhe Këshilli i Përgjithshëm i Bashkimeve Profesionale, organizata tjetër e masave si subjekt elektoral në zgjedhjet parlamentare. Që në fillim të dokumentit zyrtar të mbledhjes deklarohet se BPSH *mbështet vendimin e Plenumit të 13 të KQ të PPSH për thellimin e proceseve demokratike si masë e rëndësishme që do të përshpejtojë zhvillimin e demokracisë në vend*⁵⁵.

Interesant është fakti se secili prej subjekteve elektorale, BG, BR, FD, KV etj., theksonin në preambulën e programit të tyre politik se janë organizata shoqërore e politike të pavarura që bashkojnë rreth vetes qytetarë të të gjitha kategorive, pa dallim përkatësie politike, bindje ose besimi. Përcaktimi “*pa dallim përkatësie politike*” ishte larg konceptit të një partie politike dhe tregonte sa krizën e identitetit në formatimin e këtyre subjekteve aq edhe përpyjekjen e tyre për të përfituar nga slogani i njohur i Konferencës së Pezës, në kontestin e ri zgjedhor.

Pas mesit të dhjetorit 1990, Shqipëria hyri në një fazë të re politike dhe historike. Kushtetuta e vitit 1976 mbeti në fuqi deri në prill 1991, në janar 1991 doli një dekret i posaçëm⁵⁶ që siguronte mbrojtje ligjore për emrin dhe statujat/monumentet nderuese të Enver Hoxhës, ndërkohë që zgjedhjet e 10 shkurtit u shtynë për datën 31 mars 1991. Nga subjektet konkurruese të nxitura nga PPSH përpara shpalljes së pluralizmit politik hynë në garën elektorale katër prej tyre, Fronti Demokratik, Bashkimi i Rinisë, Bashkimi i Grave dhe Komiteti i Veteranëve. Minoriteti grek krijoi organizatën “Omonia”. PPSH ishte subjekti kryesor në zgjedhje,

⁵³ “Programi i Bashkimit të Grave të Shqipërisë për zgjedhjet në Kuvendin Popullor”, në gazetën *Bashkimi*, Tiranë, më 25.12.1990.

⁵⁴ “Organizata e Veteranëve të Luftës, Programi elektoral”, në gazetën *Bashkimi*, Tiranë, më 26.12.1990.

⁵⁵ “U mbledh Këshilli i Përgjithshëm i BPSH”, në gazetën *Bashkimi*, Tiranë, më 23 dhjetor 1990.

⁵⁶ Dekret nr. 7459 “Për respektimin dhe mbrojtjen e monumenteve që lidhen me historinë kombëtare dhe të simboleve shtetërore”, 22.01.1991, në *Fletore Zyrtare*, nr. 2, shkurt 1991.

PD, PR dhe “Omonia” bënë pjesë tek partitë e opozitës, kurse Partia Ekologjike konkurroi e nxitur nga PPSH. I vetmi subjekt nga organizatat e masave që refuzoi pjesëmarrjen në zgjedhje (pas shpalljes së pluralizmit politik) ishte Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve, ndërkohë që kryetari i këtij subjekti Dritero Agolli ishte njëherësh kandidat i PPSH dhe fitoi mandat në emër të saj në zgjedhjet e marsit 1991. Në përfundim të votimit, tre drejtues të organizatave të masave, Çarçani (FD), Rexha (BG) dhe Lleshi (KV), të tre kandidatë zyrtarë të PPSH në zgjedhje, fituan mandate parlamentare por u deklaruan si anëtarë të grupit parlamentar të PPSH (më pas të PS). Raportet ndërkombëtare mbi zgjedhjet shprehën kritika të ashpra për ekzistencën e subjekteve fiktive, të cilat përbënin rreth 50% të të gjitha subjekteve zgjedhore konkurruese në zgjedhje⁵⁷.

Vetëm pas zgjedhjeve të marsit 1991, jeta politike në Shqipëri hyri në shtratin e pluralizmit real politik. Subjektet fiktive të organizatave të masave u tërhoqën nga politika aktive dhe nisën procese të brendshme intensive, por edhe shumë të vështira, reformuese. Pas një viti shumica e tyre nuk ekzistonin më. Në qershor 1991 edhe PPSH mbylli historinë e saj politike dhe u shndërrua në Partia Socialiste. Me ligjin elektoral të vitit 1992 u ndalua shprehimisht konkurrimi në zgjedhje i shoqatave dhe grupimeve të tjera jashtë formatit të partive politike. Si pasojë e ligjit të ri, edhe organizata “Omonia” përfaqësuese e minoritetit grek në Shqipëri i dha fund konkurrimit në zgjedhje dhe krijoi paralelisht subjektin politik PBDNJ, parti e cila vijon të jetë konkurruese e rregullt në procese zgjedhore dhe me përfaqësim politik në nivel qendror e lokal.

Përfundime

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 1990 PPSH, e ndodhur nën presion të fortë të brendshëm (rritja e zërave kritikë, ngjarjet e ambasadave, intervistat në mediet e huaja dhe protesta lokale) dhe të jashtëm (deklarimet për kushtëzime politike nga KSBE, TRE dhe shtete të ndryshme perëndimore) u përpoq të krijonte një sistem fiktiv konkurrues të kontrolluar dhe të dominuar prej saj. Qëllimi kryesor ishte që procesi zgjedhor i shkurtit 1990 të çonte në “forcimin e karakterit popullor të pushtetit” dhe të “demokracisë së masave”. Nismat politike të PPSH

⁵⁷ Instituti Republikan Amerikan (IRA), *Election's Report*, Uashington: 1991, f. 4.

përfshirë ligjin e ri mbi zgjedhjet, takimet me intelektualët, me rininë etj., u përshkuan nga paqartësia dhe pavendosmëria për një agjendë reformash, mungesa e vizionit dhe pafuqia për ndryshim si dhe nga distanca e madhe midis imazhit të elitës qeverisëse ndaj shoqërisë dhe vetë shoqërisë shqiptare.

PPSH nuk ia arriti ta udhëheqë dhe as realizojë procesin e transformimit historik drejt një shoqërie të hapur. Një numër i madh dokumentesh origjinale zyrtare të diskutimeve dhe vendimmarrjeve në Byronë Politike, në Sekretariatën e KQ, në Plenumet e KQ, në Këshillin e Ministrave, në Presidiumin e Kuvendit dhe në vetë Kuvendin Popullor, janë provë e rëndësishme për tezën se udhëheqja komuniste e Shqipërisë, 1990 kishte koncepte minimaliste mbi institucionin e zgjedhjeve dhe koncepte të gabuara mbi pluralizmin politik dhe demokracinë funksionale. PPSH nuk shikonte dallime themelore midis konceptit të shtetit dhe të pushtetit dhe ishte e gatshme të toleronte deri në pikën kur mund të cenohej sadopak pushteti politik i saj. Ajo shfaqte kontraste të thella midis retorikës e ligjërimit publik me retorikën e ligjërimit jopublik në strukturat e saj vendimmarrëse, si dhe bëri përpjekje maksimale për zëvendësimin e pluralizmit politik me një formë fiktive të tij, përmes të cilës sigurohej vazhdimësia e sistemit në rrethana të reja dhe roli udhëheqës i vetë PPSH.

Ekspërimenti me subjekte fiktive elektorale, me pluralizëm të kontrolluar e formal politik, si dhe me zgjedhje fiktive politike, dështoi duke simbolizuar edhe dështimin e aksionit më të madh politik të regjimit gjatë gjysmës së dytë të vitit 1990 dhe me to, edhe rënien e tij. Në dallim nga shumica e modeleve të vendeve ish komuniste procesi i vetëdijes demokratike në Shqipëri erdhi vonë, i paplotë, me mungesë në formimin demokratik dhe elitat reformatore dhe ekspërimenti unik me subjektet, zgjedhjet dhe pluralizmin fiktiv në nëntor 1990 është një prej simbolikave më domethënëse të këtij procesi.

S u m m a r y

EFFORTS OF ALBANIA'S PARTY OF LABOUR (PLA) TO ENFORCE FICTITIOUS ELECTIONS AND TO "PLURALISE THE MASSES" DURING 1990

The 1990s with its ground-breaking political events leading to the advent of political pluralism and to the end of the one-party system in Albania remains a rich source of documentary evidence and a trove of facts for historical and political analysis.

The Communist regime went at great lengths and made considerable efforts to create a new image for itself without compromising the core system and its own political control over it. It firmly rejected the thesis of political pluralism by describing it as a direct result of hostile political pressure from outside and then as political pressure from various protest groups within the country.

For the leadership of PLA, the process of creating some sort of formally competitive political organizations, engaging into internal party debates and party consultations with the masses was more than enough in terms of what was acceptable vis-à-vis actual political pluralism. An analysis of the narratives prevailing during this initial period, based on archival and official documents, from Albanian and foreign media reports shows that the communist elite was unaware of the country's actual situation and its challenges.

The PLA failed to timely grasp the importance the process of historical transformation towards an open society in Albania. It did not understand the fundamental difference between the concept of state institution and the concept of state power and was willing to tolerate differences only up to the point where its political power could not be substantially undermined. Within PLA, its leaders failed to understand the basics of the concepts of democracy and pluralism. As a result of this, PLA and its leader Ramiz Alia made the utmost efforts to replace actual political pluralism with its fictitious form, so as to ensure the continuity of their grip on the system under the new circumstances without compromising PLA's leading role.

This paper analyses the political aspect of this process, focusing on the political, official, and public discourse on democracy and pluralism, the expectations of new changes in the electoral law, and on the considerable PLA-sponsored efforts to deliver "pluralism of masses" as pluralist politics, and to impose a fictitious pluralism by planting in the political scene competing political subjects generated by its own satellite organizations.

This paper analyses the internal dynamics and the internal developments affecting the first pluralist elections and their final phase. It also looks into the formation of the first pluralistic political subjects that participated in the elections held in March 1991. This paper argues that in contrast to most models of former communist countries, the process leading to Albania's democratic self-awareness came late, it was incomplete, as its political elites were found wanting of a good level of formation with regard to democracy; hence, what followed was, an unique experiment with political subjects, faked elections and fictitious pluralism, culminating in the happenings of November 1990 as one of the most symbolically important episodes of this process.

